

PLANI EKONOMIK LOKAL PËR
KATEGORITË E CENUESHME TË
QYTETARËVE, TË
RIATDHESUARVE DHE
ANËTARËVE TË FAMILJEVE TË
TYRE PËR KOMUNËN E ÇAIRIT

Ky publikim është përgatitur si pjesë e projektit “Rruga drejt rezistencës dhe riintegritit të familjeve të cenueshme në komunitet”, i cili zbatohet nga një konsorcium i organizatave: Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar - MCMS, Nexsus - Koncepti qytetar, Iniciativa për Perspektivë Evropiane - IEP , Horizon Civitas dhe Pleiades. Projekti mbështetet nga Fondi global i angazhimit dhe rezistencës së Komunitetit-GCERF.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autorit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i pasqyron pikëpamjet e GCERF ose organizatave të tjera që e zbatojnë programin.

Autor: Goran Veleski

prill-maj 2022

Përmbajtja

Rezyme.....	3
Të dhëna themelore për Komunën e Çairit	6
Risocializimi, rehabilitimi dhe riintegrimi i të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre	7
Riintegrimi ekonomik – Qëllimi strategjik dhe masat.....	9
Orientimi në karrierë	10
Forcimi i kualifikimeve dhe shkathtësive lidhur me punësimin.....	11
Punësimi i subvencionuar në organizatat qytetare me mision social (ndërmarrje sociale) ose ndërmarrje me përgjegjësi shoqërore	12
Vetëpunësimi	13
Rekomandime	14

Plani ekonomik lokal për kategoritë e cenueshme të qytetarëve duke përfshirë të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre për Komunën e Çairit

Rezyme

Format e ndryshme të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit janë dukuri globale që çdo shoqëri duhet t'i kundërshtojë aktivisht dhe me vendosmëri në nivel lokal, shtetëror, rajonal dhe ndërkombëtar. Rajoni i Ballkanit Perëndimor është një nga rajonet më të ndjeshme, duke pasur parasysh trashëgiminë negative të luftërave të fundit të shekullit të 20-të, të ndërthurura me interesa dhe ndikime të ndryshme, por edhe rreziqe të polarizimit në shoqëri.

Pas kthimit të të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjareve të tyre, lind detyrimisht nevoja për riintegrimin e tyre në shoqëri, pra në mjedisin ku jetojnë.

Riintegrimi është procesi me anë të të cilit të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre fitojnë statusin civil dhe fitojnë punësim dhe të ardhura të qëndrueshme. Që në thelb përfaqëson një proces social dhe ekonomik me një kornizë kohore të hapur.

Në përputhje me nevojat dhe sfidat me të cilat po përballlet shoqëria jonë pas ardhjes së të riatdhesuarve, është evidente nevoja për një qasje holistike në lidhje me integrimin e tyre në shoqëri. Veprimi sistematik dhe vullneti për bashkëpunim i të gjitha subjekteve shoqërore të referuara janë çelësi i riintegrimit të suksesshëm. Veprimi sistematik imponon domosdoshmërisht nevojën e përgatitjes së një Plani dhe Programi për integrimin e të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre, i cili do të parashikojë në detaje aktivitetet që duhet të ndërmerren për të realizuar me sukses procesin e planifikuar.

Nevoja për riintegrim të të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre kërkon një angazhim të veçantë të “shoqërisë në tërësi”, pra aplikimin e një reagimi social gjithëpërfshirës dhe të integruar të bazuar në një partneritet ndërmjet institucioneve shtetërore, komunitetit lokal, sektorit civil, komunitetet fetare, komuniteti akademik dhe mediat. Proces i deradikalizimit, rehabilitimit dhe riintegrimit të të riatdhesuarve në shoqëri është një proces i ndjeshëm që kërkon vëmendje të madhe në procesin e krijimit të programeve dhe planeve, si dhe përfshirjen aktive të të gjithë subjekteve të ftuar në proces, për të siguruar zbatimin e suksesshëm të procesit. Anëtarët e familjeve të tyre që ishin me ta, si dhe familjet, anëtarët e

të cilave kanë vdekur në fushën e betejës ose janë të zhdukur, duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë.

Pranimi i të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre nga shoqëria, arsimimi, përfundimi i trajnimeve për konkurrencë më të madhe në tregun e punës dhe sigurimi i mjeteve financiare për fillimin e mikrobizneseve të suksesshme janë sfidat kryesore që qëndrojnë në rrugën drejt riintegrit të suksesshëm.

Trajtimi në punë është një nga kushtet për riintegrim të suksesshëm, i cili duhet të zbatohet përmes planeve dhe masave të hartuara mirë për riintegrimin ekonomik (të punës) me aktivizimin e tyre në tregun e punës, mbështetjen gjatë dhe pas punësimit.

Politikat aktive në tregun e punës të plotësuara dhe të përshtatura sipas nevojave individuale mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në aktivizimin e tregut të punës dhe punësimit.

“Në bazë të përvojës sonë, dëshiroj t’i siguroj ata që janë skeptikë për riintegrimin e qytetarëve të tyre, se rezultatet e arritura përmes proceseve rehabilituese janë bindëse. Sidoqoftë, kjo nuk është arsye për festë. Proceset e rehabilitimit janë shumë të brishta. Ato kërkojnë vëmendje të vazhdueshme të përditshme nga dhjetëra specialistë. Në disa raste, mund të na duhen disa vite për t’i riintegruar plotësisht njerëzit në shoqëri. Ne duhet të jemi të gatshëm t’i shoqërojmë në këtë rrugë të vështirë”.

-Oliya Ilmuradova, Director of Barkaror Hayot

Metodologjia për përpilimin e planit ekonomik lokal për kategoritë e cenueshme të qytetarëve dhe riintegrimi i të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre në Komunën e Çairit

Ky plani ekonomik lokal për kategoritë e cenueshme të qytetarëve është përgatitur duke mbledhur, organizuar dhe sintetizuar në mënyrë sistematike informacionet në dispozicion.

Hulumtimi kishte për qëllim kuptimin e kontekstit në vend në nivel kombëtar dhe lokal, si dhe prioritetet dhe tendencat e riintegritit ekonomik të riatdhesuarave dhe anëtarëve të familjeve të tyre.

Aktivitetet përfshijnë analizën e literaturës ekzistuese, analizë e të dhënave dytësore dhe krijimin e një liste referimi në mënyrë që të gjitha dokumentet të jenë të organizuara dhe lehtësisht të aksesueshme.

Analiza e literaturës ekzistuese relevante për riintegrimin ekonomik përfshin një rishikim të rregulloreve ekzistuese, dokumenteve strategjike, planeve të veprimit dhe operacionale, raporteve për zbatim, teksteve gazetareske, etj. Gjithashtu u rishikua literatura shkencore nga praktikantët në shtetet e tjera dhe komunitetet lokale që përballen me këtë problem.

Pas shqyrtimit të literaturës ekzistuese, filloi analiza e të dhënave të disponueshme publike, si të dhëna demografike, ekonomike, sociale, të dhëna arsimore, si dhe të dhëna nga tregu i punës. Të dhënat janë përdorur për të perceptuar situatën dhe për të propozuar politika/masa për riintegrimin ekonomik, të bëra në bazë të të dhënave të disponueshme.

Gjatë përgatitjes së Planit ekonomik për riintegrim në nivel lokal, janë marrë njohuritë nga drafti i hulumtimit për nevojat e tregut të punës për të riatdhesuarit dhe familjet e tyre, i cili është realizuar në tranzicionin para përgatitjes së planeve ekonomike.

Të dhëna themelore për Komunën e Çairit

Komuna e Çairit shtrihet në pjesën veriperëndimore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ose në pjesën verilindore të Qytetit të Shkupit dhe shtrihet në një sipërfaqe prej 3,25 km². Pozita e Komunës së Çairit në luginën e Shkupit është e favorshme, por nuk ka territor të mjaftueshëm për zhvillimin e zonave të caktuara industriale. Komuna e Çairit është në zhvillim të vazhdueshëm dinamik, si në aspektin ekonomik ashtu edhe në atë demografik. Gjashtë njësi urbane ndodhen brenda komunës: pjesë të Gazi Babës, Duqanxhikut, Çarshisë së Vjetër, Fushë Topanës, Qeramidhes dhe Çairit.

Për sa i përket dendësisë së popullsisë, Komuna e Çairit karakterizohet me faktin se është komuna më e dendur e populluar në Maqedoninë e Veriut, ku dendësia është 16,193 banorë/km². Zona me popullsi të dendur është arsyeja pse komuna po ballafaqohet me probleme nga sfera urbane, e në veçanti është evidentuar problemi i parkimit.

Sipas të dhënave zyrtare nga regjistrimi i fundit i popullsisë në vitin 2002, në Komunën e Çairit numërohen 17.107 amvisëri, ndërsa gjendja numerike e popullsisë sipas regjistrimit të popullsisë është 64.773 banorë, prej të cilëve 32.374 janë meshkuj dhe 32.399 janë gra. Komuna e Çairit është përfshirë në grupin e komunave me natalitet të lartë dhe shtim natyror. Popullsia që banon në Komunën e Çairit karakterizohet me ndryshime të theksuara në strukturën demografike, në drejtim të rritjes së pjesëmarrjes së të rinjve në kurriz të popullsisë së moshuar.

Shumica e popullsisë në Komunën e Çairit janë të nacionalitetit shqiptar (57%), pasuar nga maqedonas (24%), turq (7%), romë (5%), boshnjakë (5%), serb (1%) dhe të tjerët (1%).

Në territorin e Komunës së Çairit ekzistojnë tetë shkolla fillore, një shkollë e mesme dhe gjashtë kopshte.

Komuna e Çairit ka dy institucione për mbrojtje sociale. Në territorin e komunës janë të regjistruara dy shoqata tregtare për punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Risocializimi, rehabilitimi dhe riintegrimi i të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre

Riintegrimi si koncept nënkupton një sërë aktiviteteve sistematike që kryhen për të ri-incorporuar në shoqëri individin, i cili për disa arsye është marginalizuar prej saj. Në këtë rast bëhet fjalë për një kategori të veçantë shtetasish që për arsye të ndryshme janë larguar drejt Sirisë dhe Irakut. Një pjesë e madhe e tyre u përballën me situata shumë traumatike dhe tmerret që sjell lufta, ndaj pas kthimit në vendlindje është e nevojshme t'u sigurohet mbështetje psiko-sociale, kujdes shëndetësor, strehim, por edhe përgatitja e komunitetit për pranimin e tyre.

Krahas obligimeve ligjore të parashikuara në legjislacionin kombëtar, si kornizë ligjore për rregullimin e procesit të riintegrit, ekzistojnë edhe një sërë instrumentesh ndërkombëtare që deklarojnë rekomandimet dhe praktikat më të mira. Midis tyre do të veçonim dokumentin “Parimet malteze për riintegrimin e terroristëve të huaj – luftëtarët e kthyer” (2016)¹, i cili është një nismë e Qendrës për hulumtime Hedaya dhe Institutit Ndërkombëtar për Drejtësi dhe Sundim të Ligjit, i cili propozon 22 parimet, sipas të cilave vendet mund të udhëhiqen në zhvillimin e politikave dhe programeve për riintegrimin e të riatdhesuarve. Vlen të theksohen disa parime nga ky dokument:

- Zbatimi i vlerësimeve efektive për të përcaktuar qasjen më të mirë ndaj nevojave të të riatdhesuarve në programin e riintegrit (Parimi nr. 3)
- Autoritetet për zbatimin e ligjit luajnë një rol kyç në riintegrimin e suksesshëm (Parimi nr. 6)
- Programet e riintegrit duhet të angazhojnë ekipe të ndryshme multidisiplinare ekspertësh, të cilët do të punojnë në koordinim të ngushtë me zyrtarët përkatës (Parimi nr. 7)

Programi i riintegrit duhet të hartohet në atë mënyrë që t'i përgjigjet nevojave specifike të individit që trajtohet, sepse çdo person reagon ndryshe për shkak të karakteristikave dhe besimeve të ndryshme fizike, psikologjike, intelektuale. Programet dhe planet duhet të parashikojnë në mënyrë të detajuar aktivitetet që duhet të ndërmerren, për të realizuar me sukses procesin e planifikuar.

Një nga parimet e dokumentit “Parimet malteze për riintegrimin e terroristëve të huaj - luftëtarëve të kthyer” e thekson rolin kyç të autoriteteve ekzekutive në suksesin e riintegrit të të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre. Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme

¹ Hedayah and The International Institute for Justice and the Rule of Law, “The Malta Principles for Reintegrating Returning Foreign Terrorist Fighters” (2016)

që të bëhet një plan riintegruar, i cili do të zbatohet nga nëpunësit të cilët do t'i nënshtrohen trajnimit të veçantë për menaxhimin e procesit të riintegrit, me ndihmën e të cilit ata do të jenë në gjendje t'i përgjigjen në mënyrë adekuate kërcënimeve të mundshme, të krijojnë komunikim dhe koordinim me të gjitha subjektet që do të përfshihen në procesin e zbatimit të programit të riintegrit. Gjatë realizimit të programeve dhe planeve për riintegrim, është veçanërisht e rëndësishme të zhvillohen partneritete me komunitetin lokal dhe sektorin civil që mund të ofrojnë mbështetje të konsiderueshme.

Për zbatimin me sukses të programit për rehabilitim dhe riintegrim, nevoja për veprim të një ekipi multidisiplinar, i përbërë nga juristë, punëtorë socialë, psikologë, mjekë, liderë fetarë si dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, të cilët do të bashkëpunojnë si në planifikim, ashtu edhe në procesin e realizimit të programit.

Krijimi i programeve dhe planeve për riintegrim, risocializim dhe rehabilitim duhet të jetë një proces i sistemuar mirë (nga aspekti metodologjik dhe institucional) dhe një proces i qëndrueshëm (burime të siguruara financiare dhe njerëzore).

Plani ekonomik për integrimin e të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre i përpunon masat dhe aktivitetet për riintegrimin ekonomik, si një segment i veçantë i të gjithë procesit të riintegrit dhe do të përfshijë mundësitë për kualifikimet dhe aftësitë arsimore që ata mund të fitojnë, si parakusht i rëndësishëm për të gjetur punësim, por edhe për integrim të plotë të suksesshëm.

Riintegrimi ekonomik – Qëllimi strategjik dhe masat

Planifikimi i zhvillimit ekonomik është një komponent kyç i riintegrit, duke pasur parasysh sfidat e krijimit të vendeve të punës për të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre. Riintegrimi ekonomik përmban dy dimensione:

- Përmirësimi i punësueshmërisë: rritja e punësueshmërisë së të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre nëpërmjet trajnimit intensiv në aftësitë që kërkohen në ekonomitë lokale dhe nëpërmjet mbështetjes afatgjatë për sipërmarrësit e rinj (për shembull nëpërmjet mentorimit dhe shërbimeve mbështetëse të biznesit.)
- Fuqizimi i përfshirjes në mjedisin lokal: krijimi i një mjedisi ekonomik gjithëpërfshirës për krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin e sektorit privat.

Qëllimi strategjik i planit të riintegrit ekonomik është ofrimi i mundësive për punësim dhe të ardhura të denjë për kategoritë e cënueshme të qytetarëve, përfshirë të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre.

Qëllimi strategjik do të arrihet përmes shërbimeve dhe masave për aktivizimin e tregut të punës, si identifikimi i barrierave në tregun e punës, këshillimi dhe ofrimi i informacionit për karrierën, orientimi për arsimin formal dhe joformal, trajnimi në klasë dhe/ose në punë, zhvillimi i shkathtësive të nevojshme për kërkimin e punës, ndihmë në kërkimin e punës, punësim të subvencionuar (subvencionet e pagave) dhe vetëpunësimi.

Edhe në nivelin më të lartë institucional dhe në institucionet qendrore, kjo temë është trajtuar në mënyrë të kufizuar, nuk janë përgatitur dhe miratuar të gjitha planet/mekanizmat e nevojshëm për trajtimin e duhur të të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre.²

Iniciativat ekonomike të sektorit privat në komunitetet lokale mund të synojnë krijimin e mundësive për riintegrim, nga të cilat do të përfitojë edhe komuniteti më i gjerë, nëse ekonomitë lokale forcohen përmes këtyre nismave.

Procesi i riintegrit duhet të kontribuojë drejt:

- Rimëkëmbja ekonomike në kohë dhe stabilizimi i të ardhurave,
- Krijimi i vendeve të punës nga ekonomia lokale,
- Punësim i qëndrueshëm dhe punë e denjë.

Aktorët kryesorë në integrimin ekonomik të kategorive të cënueshme të qytetarëve duke përfshirë të riatdhesuarit dhe familjet e tyre në nivel lokal janë: Komuna e Çairit, Qendra për punësim-Shkup, ndërmarrjet lokale me përgjegjësi shoqërore, organizatat lokale të shoqërisë

² Propozim-Hulumtim për nevojat e tregut të punës për të riatdhesuarit dhe familjet e tyre

civile me mision social (ndërmarrjet sociale). ofruesit lokal të trajnimeve të certifikuara të të rriturve, Qendra për punë sociale-Shkup dhe shkollat e mesme profesionale në nivel lokal.

Plani ekonomik për integrim parashikon masat e mëposhtme:

Identifikimi i barrierave me të cilat përballen të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre në tregun e punës

Analiza e barrierave të tregut të punës me të cilat përballen të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre duhet të ketë një qasje individuale. Në drejtim të punësimit të denjë, ka disa pengesa të mundshme me të cilat mund të përballen, si: mungesa e arsimit adekuat, mungesa e përvojës së punës, nevoja për t'u kujdesur për anëtarët e familjes, gjendja e keqe financiare, puna joformale, aksesit i kufizuar në arsim, mbështetje e kufizuar shëndetësore dhe sociale, mungesë informacioni për mundësitë, stigmatizimi, mungesa e mundësive të jetesës, dekurajimi dhe më shumë. Disa nga këta njerëz përballen me një, disa me dy dhe disa me më shumë pengesa. Prandaj është i nevojshëm zbulimi në kohë të tyre dhe krijimi i planeve për tejkalimin e sfidave të integritit ekonomik. Për të kapërcyer disa nga barrierat e integritit ekonomik, ekzistojnë masa në nivel kombëtar, si Plani operativ për programe aktive dhe masa për punësim dhe shërbime në tregun e punës, por fatkeqësisht këta persona nuk njihen si një grup i veçantë i cënueshëm në tregun e punës në shumicën e masave.

Orientimi në karrierë

Orientimi në karrierë është një proces që përfshin shumë më tepër aktivitete sesa testime të thjeshta ose edukim për zgjedhjen e karrierave ose profesioneve të disponueshme. Përkundrazi, duhet të jetë një proces mirë i përcaktuar, përmes të cilit kategoritë e cënueshme do të marrin informacione dhe mbështetje në mënyrë që ato të bëjnë zgjedhje reale për të ardhmen e tyre përse i përket karrierës, arsimit të mëtejshëm dhe synimeve personale. Individët duhet të jenë pjesëmarrës aktivë në procesin e përcaktimit të qëllimeve të tyre dhe hapave që duhet të ndërmerren për të arritur qëllimet. Gjithashtu, njerëzit duhet të marrin informacione për qëllimet që mund të arrijnë në të ardhmen dhe të motivojnë veten për të arritur rezultate.

Orientimi në karrierë mund të përfshijë fusha të ndryshme të intervenimit, dhe atë:

- Arsimi: kjo fushë përqendrohet në sigurimin e mjeteve për të marrë vendime të përshtatshme në lidhje me edukimin e tyre formal dhe mbështetjen gjatë arsimit të tyre.
- Arsimi profesional: kjo fushë fokusohet në aftësitë, interesat dhe aftësitë e tyre në drejtim të tregut të punës.

- Psiko-sociale: kjo fushë fokusohet në ndihmën e kategorive të cenueshme që të njohin veten, të zbulojnë potencialin e tyre dhe të marrin vendime që do t'i ndihmojnë në riintegrimin e tyre.

Orientimi në karrierë është veçanërisht i rëndësishëm për riangazhimin në tregun e punës. Orientimi efektiv në karrierë i ndihmon individët të arrijnë potencialin e tyre, të bëhen më të fortë ekonomikisht dhe të integrohen më lehtë në shoqëri.³ Orientimet në karrierë nuk duhet të ndalen me punësimin e personave, duke pasur parasysh se ata mund të jenë sërish të papunë.

Komuna e Çairit, përmes bashkëpunimit të ngushtë me organizatat e shoqërisë civile, institucionet (p.sh. Qendra e punësimit, Qendra për punë sociale, shkollat e mesme profesionale lokale, qendrat e arsimit të të rriturve, etj.) dhe punëdhënësit duhet të ofrojnë shërbime të orientimit në karrierë përmes këshilltarëve për karrierë.

Forcimi i kualifikimeve dhe shkathtësive lidhur me punësimin

Arsimi, aftësimi profesional dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës janë shtylla qendrore të punësimit, punësimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të ndërmarrjeve lokale. Zhvillimi i shkathtësive është çelësi për stimulimin e një karriere të qëndrueshme, e cila mund të ndihmojë në lehtësimin e tranzicionit nga punësimi informal në atë formal.

Trajnimet profesionale ofrojnë zhvillim të shkathtësive në një gamë të gjerë fushash profesionale, përmes mësimin në klasë dhe në vendin e punës. Ato duhet të dizajnohen për të ndërtuar aftësitë dhe njohuritë e këtyre individëve, të cilat janë në përputhje me nevojat e punëdhënësve. Këto trajnime luajnë një rol kyç në sigurimin e punësimit më të mirë afatgjatë.⁴

Në nivelin e Komunës së Çairit, e cila është pjesë e Qytetit të Shkupit, ekzistojnë mundësi trajnimi që financohen nga shteti dhe janë pjesë integrale e Planit operativ për programe dhe masa aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës, të cilat zbatohen nga Agjencia e punësimit. Në vitin 2022 është planifikuar trajnimi për mbi 1300 persona në nivel shtetëror.

Kategoritë e cenueshme të qytetarëve në Komunën e Çairit mund të trajnohen në sektorët ku ka kërkesë për fuqi punëtore, siç janë sektorët: tregtia me shumicë dhe pakicë, katering, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave, industria përpunuese, ndërtimtaria, transporti dhe magazinimi etj.⁵

Në rajonin e Shkupit ka kërkesë për teknik mekanik, infermier, teknik farmaceutik, teknik ndërtimi, shitës, arkëtar, shofer kamioni, kamarier, rrobaqepës, magazinier, kuzhinier,

³ Investing in career guidance, revised edition 2021 – CEDEFOP.

⁴ Vocational Education and Training (VET) and Adult Learning, OECD 2022.

⁵ Anketë për nevojat e shkathtësive në tregun e punës në Republikën e Maqedonisë së veriut për vitin 2020

bravandreqës, saldator, punëtor ndërtimi, murator, higjienist, punëtor për ngarkim-shkarkim, ndihmës kuzhine, punëtor bujqësor etj.

Një pjesë e këtyre trajnimeve realizohen nga Agjencia për punësim, përmes Qendrës për punësim në Shkup në nivel lokal. Ato kryhen nga ofruesit e verifikuar të trajnimit (shkollat e mesme profesionale, ndërmarrjet private, odat ekonomike, odat e artizanatit, etj.). Në nivel të Qytetit të Shkupit janë të verifikuara mbi 100 trajnime për kualifikime apo aftësi. Llojet e trajnimeve në nivel lokal, në të cilat këta persona mund të marrin pjesë dhe të fitojnë kualifikimet apo aftësitë e nevojshme, mund të shihen në faqen e Qendrës së Arsimit të të Rriturve në linkun e mëposhtëm [Lista e programeve – TIS \(cov.gov.mk\)](https://cov.gov.mk).

Punësimi i subvencionuar në organizatat qytetare me mision social (ndërmarrje sociale) ose ndërmarrje me përgjegjësi shoqërore

Punësimi i subvencionuar është një politikë aktive në tregun e punës, e cila mund të përdoret nga punëdhënësit dhe kategoritë e cenueshme të personave të papunë dhe paraqet një mundësi adekuate për punësim për të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre. Kjo masë subvencionon pagat për një periudhë nga 3 deri në 12 muaj dhe ndikon në kërkesën për punësim. Financimi ndihmon në uljen e hendekut të produktivitetit, kështu që punëdhënësit kanë një interes të fortë në përdorimin e masës.

Punësimi i subvencionuar (Subvencioni i pagave) është masë aktive në Planin operativ për masa aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës për vitin 2022, i cili zbatohet nga Agjencia e punësimit, përmes qendrave të punësimit në nivel lokal. Në vitin 2022, kjo masë është planifikuar të mbulojë rreth 1500 persona nga kategori të ndryshme të cenueshme në tregun e punës.

Plani operativ përcakton kategoritë e cenueshme të cilat janë vështira për t'u inkuadruar në tregun e punës, konkretisht: personat e papunë afatgjatë (më shumë se 12 muaj në evidencë, me preferencë ndaj personave të papunë mbi 5 vjeç), të rinjtë deri në 29 vjeç, personat mbi 50 vjeç, personat e papunë të cilëve u ka përfunduar marrëdhënia e punës gjatë periudhës së korona virusit COVID-19, të kthyerit nga jashtë për shkak të krizës së shkaktuar nga korona virusi COVID-19, personat që marrin asistencë minimale të garantuar, personat që marrin përfitime në para në bazë të papunësisë, personat që kishin statusin e fëmijëve pa prindër dhe përkujdesje prindërore, femra viktime të dhunës me bazë gjinore dhe viktime të dhunës në familje, personat me aftësi të kufizuara, gratë që i përkasin komunitetit etnik rom dhe komuniteteve të tjera etnike, personat që i përkasin komunitetit etnik rom, personat që nuk kanë status të zgjidhur me dokumentacion personal, prindër të vetëm, prindër të fëmijëve me pengesa në zhvillim, prindër të 3 ose më shumë fëmijëve, prindër të fëmijëve në rrugë,

personat e dënuar pas lirit nga institucioni i vuajtjes së dënimit, personat e pastrehë, personat me arsim të mesëm ose të ulët të paplotë dhe gratë.

Vetëpunësimi

Vetëpunësimi është një masë që mund të mbështesë personat që duan të krijojnë biznesin e tyre apo të formalizojnë një biznes ekzistues, përmes granteve për pajisje dhe materiale në vlerë prej 5.000 euro. Masa e vetëpunësimit mund të jetë një mundësi e mirë për qasje te kapitali, në rast se personi zotëron aftësi për profesione të veçanta, si parukier, estetist, marangoz, këpucar, trajnues i gjuhëve të huaja, riparues automjesh etj.

Kjo masë është pjesë e Planit operativ për programe dhe masa aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës, i cili zbatohet nga Agjencia e punësimit në bashkëpunim me Agjencinë për zhvillimin e ndërmarrësisë. Shpallja për pjesëmarrje në masë publikohet një ose dy herë në vit. Në vitin 2022, rreth 2.000 persona janë planifikuar të përfshihen nga masa.

Rekomandime

1. Procesi i riintegritit ekonomik duhet të kontribuojë në rimëkëmbjen ekonomike në kohë dhe stabilizimin e të ardhurave, krijimin e vendeve të punës në ekonominë lokale, punësimin e qëndrueshëm dhe punën e denjë. E njëjta gjë mund të realizohet përmes pjesëmarrjes në politikat aktive në tregun e punës, të përcaktuara në Planin operativ për programet dhe masat aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës për vitin 2022.
2. Kategoritë e cenueshme të qytetarëve në Komunën e Çairit mund të trajnohen në sektorët ku ka kërkesë për fuqi punëtore, siç janë sektorët: tregtia me shumicë dhe pakicë, hotelieri, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave, industria përpunuese, ndërtimtaria, transporti dhe magazinimi etj. Në rajonin e Shkupit ka kërkesë për teknik mekanik, infermier, teknik farmaceutik, teknik ndërtimi, shitës, arkëtar, shofer kamioni, kamarier, rrobaqepës, magazinier, kuzhinier, bravandreqës, saldator, punëtor ndërtimi, murator, higjienist, punëtor për ngarkim-shkarkim, ndihmës kuzhine, punëtor bujqësor etj.
3. Personat që kanë njohuri dhe afinitete për ndërmarrësi mund të hapin biznesin e tyre, p.sh. parukiere, estetiste, marangoz, këpucar, bukëpjekës, trajnues i gjuhëve të huaja, riparues mjetesh motorike etj., për të cilat do të mbështeteshin me grant në pajisje dhe materiale në vlerë prej 5.000 euro.
4. Punëdhënësit të cilët janë të interesuar të punësojnë person nga kategoria e cenueshme e qytetarëve, përfshirë të riatdhesuarit dhe familjarët e tyre, mund të marrin subvencione në shumë prej 19.000 denarë në muaj, si subvencion në pagën e të punësuarit për periudhën 3, 6 ose 12 muaj. Kjo masë mund të shkaktojë rritje të kërkesës për punësim të grupeve të synuara.
5. Nevojitet forcimi dhe ndërtimi i një bashkëpunimi më efektiv ndërmjet Komunës së Çairit, organizatave të shoqërisë civile me mision social, ndërmarrjeve lokale me përgjegjësi shoqërore, qendrës për punësim në Shkup, qendrës për punë sociale në Shkup, shkollave të mesme profesionale lokale dhe ofruesve për arsimin e të rriturve.